VENDIM
Nr.657, datë 18.12.2007

MBI MOSRINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR "TV SKY"

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 33 pika 1 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe vendimit nr.616, datë 1.10.2007 të KKRT-së, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Të mos rinovojë dhe të bëjë të pavlefshme licencën e subjektit televiziv privat vendor "TV SKY", pasi ka pasur mungesa në dokumentacionin e paraqitur për rinovim dhe subjekti nuk ka shfaqur ndonjë interes apo pretendim për plotësimin e tij.
2. Subjekti ka të drejtë të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative".
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)